

TJK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 294/12 Prot

Shkodër, më 31.12.2024

VENDIM

Nr. 753 datë 31/12/2024

“PËR DELEGIM KOMPETENCE”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 “Kodi Procedurave Administrative Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr.9936 , datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010 ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 ”Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit 9632 date 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar; ligjit nr.79/2017 “Për Sportin” i ndryshuar; ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar ne republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr.9270 date 29.07.2004 ”Për sistemin e adresave” të ndryshuar; ligjit nr.8308 date 18.03.1998 “Për transportet rrugore” të ndryshuar; ligjit nr.93/2015 “Për Turizmin” të ndryshuar;

VENDOSA:

- Delegimin e kompetencave të Kryetarit të bashkisë Shkodër, z.Rudin Beka me detyrë zëvendeskryetar bashkisë Shkodër;
 - Për nënshkrimin e çdo shkrese që ka të bëjë me institucionet publike, personat juridik/fizik dhe individ per:
 - Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik
 - Drejtorinë e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit
 - Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore
 - Drejtorinë e Arsimit
 - Gjendjen Civile
 - Konfirmimin e adresave të qytetareve nga sistemi.
- Zv/kryetari nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca zyrtarëve të tjerë.
- Kompetencat e deleguara do të ushtrohen duke filluar nga data 06.01.2025 dhe përfundojnë me datë 30.06.2025, ora 16.00.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet z.Rudin Beka dhe administrata bashkisë Shkodër.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen WEB të bashkisë Shkodër.

KRYETAR

Benet BECI

